

VENDIM
Nr.42, datë 7.10.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Franc Jakova	Anëtar i	"	"
Alfred Karamuço	Anëtar i	"	"
Hajredin Fuga	Anëtar i	"	"
Zija Vuci	Anëtar i	"	"
Kujtim Puto	Anëtar i	"	"
Kristofor Peçi	Anëtar i	"	"
Sokol Sadushi	Anëtar i	"	"
Hilmi Dakli	Anëtar i	"	"

me sekretare Arta Palushi, më datat 8.9.1998, 14.9.1998 dhe 7.9.1998, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen që i përket:

Kërkues: Ismet Teli, banues në Lagjen nr.18, Rr. "A.Goga", Pall.8 4, Durrës i përfaqësuar nga av.Agim Hoxha.

Subjekte të interesuara: 1. Bashkim Lleshi, banues në Tiranë.

2. Fatlum Bajraktari, i biri i Xhemalit, banues në Shkodër, i përfaqësuar nga av.dr.Shefqet Muçi.

Objekti: Deklarimi antikushtetues i vendimeve nr.2981, datë 9.12.1997 i Gjykatës së Apelit - Tiranë dhe nr.851, datë 26.6.1998 i Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi parashtroi këto shkaqe:

1. I është mohuar e drejta e njohjes së ankimit nga pala kundërshtare, pasi nuk i është komunikuar nga Gjykata e Rrethit - Durrës duke u shkelur kërkesat e nenit 447 e Kodit të Procedurës Civile, duke iu hequr mundësia e paraqitjes në gjyq dhe mbrojtjen para gjykatës.

2. Gjykimi në Gjykatën e Apelit është zhvilluar në mungesën e tij duke mos u zbatuar nenet 128 e vijues deri në nenin 133 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe kërkesën e nenit 460 të atij Kodi.

3. Gjykata e Kasacionit pa të drejtë e quan të panevojshme gjykimin e ankimit tim në seancë duke u mbështetur në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Kushtetuese, pasi dëgjoi palët, përfaqësuesit e tyre dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Padia e Bashkim Lleshit kundër kërkuesit dhe Fatlum Bajraktarit është regjistruar në gjykatën e rrethit Tiranë, më datë 31.03.1995. Në mbështetje të nenit 618 të Kodit të Ri të Procedurës Civile që ka hyrë në fuqi më 1 qershor 1996, çështjet që ishin në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të tij do të gjykohen sipas Kodit të mëparshëm, derisa vendimi të marrë formën e prerë. Kështu, që dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të cilave u referohet ankuesi nuk zbatohen për çështjen. Nga aktet e dosjes del se atij i është nxjerrë nga Gjykata e Rrethit Durrës dy herë tesë në banesë, por ato janë kthyer të pakomunikuara me shënimin se shtëpia me këtë adresë figuron e shitur. Gjykata ka bërë edhe shpallje në adresë të tij, e cila figuron në dosje. Pra, shkak i parë i ngritur prej tij se nuk është njoftuar nuk qëndron, sepse rregullat e parashikuara nga nenet 97, 98 e 99 të Kodit të Procedurës Civile të mëparshëm, rezultojnë të respektuara. Gjithashtu nuk qëndron pretendimi i moszbatimit të neneve 128-133 të Kodit të Procedurës Civile, sepse sipas nenit 165 e Kodit të Procedurës Civile të mëparshëm, njoftimi për ditën dhe orën e shqyrtimit të çështjes bëhet me shpallje të listës e jo me ftesë. Nga ana tjetër rekursi është rivendosur në afat dhe është paraqitur prej tij në Gjykatën e Kasacionit, e cila duke e gjykuar në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit me vendimin nr.851, datë 26.06.1998, sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, mbështetur në nenin 619 të Kodit të Ri të Procedurës Civile.

Nga sa më sipër nuk konstatohen shkelje të një procesi të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazw tw nenit 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", unanimsht

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.